

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations Unies
au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

T R A N S K R I P T

I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 8 MAJ 2003

PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA,
ODRŽANE 08. 05. 2003. GOD.

MAJ - 2003



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

RENDI I DITËS

1. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme
2. Shqyrtimi i Projektkodit të përkohshëm penal të Kosovës
3. Shqyrtimi i Projektkodit të përkohshëm të procedurës penale të Kosovës
4. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Komisionit për Ekonomi dhe Financa, për amendamentimin e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë
5. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Transport dhe Telekomunikacion, për amendamentimin e Ligjit për telekomunikacion
6. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Tregti dhe Industri, për amendamentimin e Ligjit për aktivitetet e tregëtisë me jashtë
7. Parashtrimi i pyetjeve
8. Propozimi i rendit të ditës për seancën plenare me 15 Maj 2003
 - 8.1 Shqyrtimi i Rezolutës për luftën çlirimtare të popullit të Kosovës për liri dhe pavarësi
 - 8.2 Shqyrtimii dytë i Projektligjit për kooperativat bujqësore
 - 8.3 Shqyrtimi i rekomandimit të Këshillit gjyqësor dhe prokurorial të Kosovës për emrimin e gjykatësve

Vrejtje : Pyetjet për Qeverinë për përgjigjet me gojë

“Pyetjet për përgjigjet me gojë duhet ti dorzohen Zyrës për parashtresa të paktën pesë ditë pune por jo më shumë se dhjetë ditë pune para kohës kur duhet përgjigjur në to “.
(Rregulla 21.2 nga Rregullorja e përkohshme e punës)



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

ДНЕВНИ РЕД

1. Усвајање записника са претходне седнице
2. Разматрање Привременог Нацрта Кривичног закона Косова
3. Разматрање Привременог Нацрта закона о Кривичном поступку Косова
4. Разматрање препоруке Комисије за Буџет и Комисије за Привреду и Фнансије о амандирању Закона о менаџирању јавним финансијама и одговорностима
5. Разматрање препоруке Комисије за Транспорт и и Комуникације о амандирању Закона о телекомуникацији
6. Разматрање препоруке Комисије за Трговину и Индустрију о амандирању Закона о спољнотрговинским активностима
7. Постављање питања
8. Предлог дневног реда за пленарну седницу од 15 маја 2003
 - 8.1 Разматрање Резолуције о ослободилачком рату народа Косова за слободу и независност
 - 8.2 Друго разматрање Нацрт закона о пољопривредним Задругама
 - 8.3 Разматрање препоруке Судско-тужилачког савета Косова о постављању судија

Опомена : Питања упучена Влади за усмене одговоре

“Питања која захтевају усмени одговор морају да буду достављена у пријемну канцеларију барем пет радних дана, али не више од десет радних дана пре него што се очекује одговор”
(Правило 21.2 са Привремени пословник)



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

AGENDA

1. Approval of the minutes of previous meeting
2. Review of the Provisional Criminal Code of Kosovo
3. Review of the Provisional Criminal Procedure Code of Kosovo
4. Review on the recommendation of the Committee of Budget and the Committee of Economy and Finance on amending the Law for management of public finances and responsibilities
5. Review on the recommendation of the Committee of Transport and Communication on amending the Law of telecommunication
6. Review on the recommendation of the Committee of Trade and Industry on amending the Law of the trade activities abroad
7. Questions
8. Proposal of agenda for the plenary session of 15 May 2003
 - 8.1 Review on Resolution for the Liberation War of people for Freedom and Independence in Kosovo
 - 8.2 Second reading of the Draft Law on Agricultural Cooperatives
 - 8.3 Review on the recommendation of the Judicial and Prosecutorial Council of Kosovo on the Nomination of judges

Note: *Questions to the Government for oral answer*

“Questions for oral answer shall be submitted to the Table Office at least five working days but not more than ten working days before they are to be answered” (Rule 21.2 of Provisional rules of procedure)

TRANSKRIPT

I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË KOSOVËS, TË MBAJTUR MË 8 MAJ 2003

**KRYESUES I SEANCËS, AKADEMIK NEXHAT DACI,
KRYETAR I KUVENDIT TË KOSOVËS.**

**BASHKËKRYESUES, GOJKO SAVIQ, ANËTAR I KRYESISË
SË KUVENDIT TË KOSOVËS.**

Seanca filloi në orën 11,00.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Mirëmëngjes apo mirëdita, si të doni. Sot po e fillojmë punën me një vonesë njëorëshe.

Para se të hyjnë në seancë plenare, ka ngjarë një incident apo një mosmarrëveshje e vogël, jashtë sallës plenare, në mes të dy deputetëve të grupacioneve të ndryshme politike. Prandaj, gjatë kësaj ore u munduam, për shkak të rëndësisë dhe agjendës shumë të rëndësishme, sot të krijojmë një unitet veprues siç kemi patur para një vit e gjysmë në Parlament. Besoj se jemi afër kësaj. Po presim që edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të na bashkëngjitet në ndërkohë. Meqë agjenda është shumë e ngjeshur, unë po i kërkoj falje Partisë Demokratike por duhet të fillojmë.

Kam marr një vendim timin, që ua kam prezentaur shefave të grupeve parlamentare. Ata dy deputetë, që kanë pasur mosmarrëveshje, sot nuk mund të jenë të pranishëm në punën e Parlamentit. Duhet të vazhdojë procedura normale, sipas rregullativës që kemi në fuqi dhe shpresojmë se kjo nuk do të përsëritet më në Parlamentin e Kosovës. Sepse, marrëveshjet ose mosmarrëveshjet individuale duhet në mënyrë demokratike jashtë seancës plenare dhe jashtë ndërtesës së Parlamentit të debatohen dhe zgjidhen.

Iu dëshiroj mirëseardhje ministrave të pranishëm. Besoj se edhe kryeministrin do ta kemi prezent së shpejti.

Meqë kemi kuorum, po fillojmë punën.

Edhe një herë po them, shpresoj që së shpejti do t'na bashkëngjiten edhe deputetët tjerë.

Materialin, së bashku me rendin e ditës, e kemi marrë me kohë.

Pikë e parë e rendit të ditës është: - **Miratimi i Procesverbalit nga seanca e kaluar.**

GOJKO SAVIĆ:

Poštovani predsedavajući, drage kolege poslanici,

Ja bih želeo nešto u vezi današnjeg dnevnog reda. Kao što vidite, tu nedostaje u svajanje dnevnog reda za današnju sednicu. Ukoliko ne postoji usvajanje dnevnog reda, to znači da je dnevni red usvojen na Predsedništvu i taj dnevni red bi trebao da bude prisutan danas ovde.

Za današnju sednicu je trebalo da bude sledeći dnevni red, sa dve tačke: Razmatranje Predloga krivičnog zakona Kosova, i Razmatranje Predloga zakona o krivičnom posutpku Kosova, koji je utvrđen na sednici Predsedništva 29. aprila 2003.godine.

Na prekjucerašnoj sednici Predsedništva, takođe, nije bilo govora o proširivanju tačaka dnevnog reda i ja bih tražio, zaista, jedno objašnjenje, jer kao što vidimo, danas pored ove dve tačke koje sam pročitao imamo još čitavu jednu gomilu tačaka koje su u međuvremenu uvrštene. I zato, predlažem da i u buduće, znači, kao što je i dosada rađeno, da tu stoji i tačka dnevnog reda znači – usvajanje predloženog dnevnog reda i da se mi izjasnimo jesmo li, ima li dopuna i slično. Hvala.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ramadan, për rend dite s'besoj se mund ta merrni fjalën, për sqarime jam unë këtu.

RAMADAN KELMENDI:

I nderuar kryetar, të nderuar deputetë dhe ministra prezent.,

Në ditët e fundit, situata e pasigurisë në Mitrovicë është ashpërsuar në shkallën më të lartë, andaj propozoj që: - **në rend të ditës të vëhet çështja e sigurisë në Mitrovicë.** Ta paraqes vetëm arsyetimin e shkurtër: - Është sulmuar kamioni i vëllezërve Hajra; është bllokuar aksi rrugor Mitrovicë-Gushavc-Vinarç; gjuajtja me pishtoletë dhe tentim vrasjeje në Besim Azemin; gjuajtja e autobusit përplotë me fëmijë e gra në relacionin Mitrovicë-Gushavc; rrahja për vdekje e Shaip Zhilivodës; rrahja e grupit të të rinjve dhe ndalimi i pacientëve të Ambulancës së dializës për të hyrë në shtëpitë e tyre.

Të gjitha këto janë bërë nga grupet serbe të pjesës veriore të qytetit. Të gjitha këto kushtëzojnë që vërtetë të merremi me këtë çështje nga se gjendja është tejet e rëndë dhe, më e rëndë, se sa u përshkrua këtu. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Mund ta marrë fjalën vetëm Dragisha, si shef i Grupit parlamentar. Debat nuk ka dhe unë do t'ia jap përgjigjen edhe Ramadanit edhe kolegut tjetër... Urdhëro Dragishë Kërstović.

DRAGIŠA KRSTOVIĆ:

Gospodine predsedniče, dame i gospodo poslanici,

Ja ovom prilikom samo hoću da postavim pitanje: - po kojoj proceduri su u dnevni red uvrštene 4., 5. i 6. tačka odnosno koje to odredbe Ustavnog okvira i Poslovnika predviđaju razmatranje preporuka Komisije za budžet i Komisije za privredu i finansije; razmatranje preporuka Komisije za transport i komunikacije i razmatranje preporuka Komisije za trgovinu i industriju o ova tri zakona – o Zakonu o menažiranju i javnim finansijama i odgovornostima; Zakon o telekomunikacijama i Zakona o spoljno-trgovinskim aktivnostima. Želim naime da mi se da odgovor: koje to konkretne odredbe, iz Ustavnog okvira i Poslovnika, predviđaju ovakvu proceduru? Hvala.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Kemi ardhur në një pozicion që edhe vetë deputetët, në mbledhje të caktuara, kërkojnë që vërtetë të vazhdojmë me një praktikë që kemi pasur një vit me radhë dhe unë mendoj se duhet t'i kthehem kësaj çështjeje. Po t'më kishin lën kohë, edhe Ramadani, edhe Dragisha, me i dhënë sqarime Saviqit, nuk do të kishin marrë fjalë të tjerët. Prandaj, ju lutem mos kërkonit fjalën vend e pavend.

E vërteta qëndron kështu. Kolegu Saviq, në Kryesi, kur është debatuar kjo, jo herën e fundit por të parafundit, nuk ka qenë i pranishëm dhe Kryesia, edhe me votim, është përcaktuar për agjendën e sotme. Ndërsa, atë që zoti Kërstović, parashtroi, në aspektin juridik dhe parlamentar, ne kemi debatuar gjatë dhe ka patur mendime të ngjashme në Kryesi, sikur kjo e zotit Kërstović, por ka predominuar një logjikë pragmatike, politikisht e pjekur, që ne si institucion dhe parlament kemi kapacitet të bashkëpunimit me UNMIK-un dhe Përfaqësuesin Special. Është kërkuar që deri më 8 maj ne t'i përgjigjemi letrës së tij dhe t'i rishqyrtojmë ligjet e theksuara. Koha ka qenë e shkurtër, komisionet kanë punuar me një përgjegjësi dhe dinamikë shumë të madhe. Unë i jam drejtuar dhe i kam kërkuar një afat shtesë zotit Shtajner që t'i jipet parlamentit kohë dhe kemi patur mirëkuptim. Prandaj, agjenda e krijuar dhe e propozuar është agjendë e diskutuar gjerësisht, ndoshta dy herë në dy mbledhjet e Kryesisë.

Tani po vazhdojmë dhe ju lutem asnjë të mos paraqitet për debat. Atë që zoti Kelmendi e tha, nuk është çështje e ngutshme. Është e rëndësishme dhe ne njëherë kemi diskutuar çështjen e sigurisë në Kosovë. Mekanizmat përgjegjës kanë marrë porositë e caktuara, prandaj ekziston ai problem, është i dhembshëm por nuk mund të hapim debat dhe të diskutojmë pa rezultate.

Ju lutem, vazhdojmë me agjendën e propozuar. Rendi i ditës është i përcaktuar. Debat dhe dialogje nuk ka. Urdhëroni, meqë jeni anëtar i Kryesisë.

GOJKO SAVIĆ:

Mogu li da iskoristim mikrofona, da ne bih silazio.

Evo koji je razlog zbog čega sam hteo... Tačno je da ja 20. aprila nisam prisustvovao, ali pred sobom imam zapisnik, znači sa održane sednice Predsedništva gde stoji potvrđivanje dnevnog reda Plenarne sednice za 8. maj, dakle za današnji dan: 4.1. Razmatranje Predloga krivičnog zakona Kosova; 4.2. Razmatranje Predloga Zakona o krivičnom postupku Kosova; i 5. Priprema za Plenarnu sednicu. Znači, priprema neka, koja treba da sledi. A potvrđeno je ovo, a ovo je priprema za sednicu koja treba da sledi i ovde je verovatno greška koja je napisana isto 8. maja. Dakle na zapisnik sa tog Predsedništva kaže ono što sam ja rekao.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Unë mendoj se kjo është pjesë e procesverbalit dhe duhet të korrigojhet e të plotësohet me atë... Nuk ka debat. Faktikisht është vërejtje me vend e zotit Savić në procesverbal ajo që ka ngjarë në Kryesi dhe ju lutem, në qoftë se ka edhe vërejtje të tilla në procesverbal, të bëhen me shkrim.

Po procedojmë. Nuk ka debat të mëtutjeshëm lidhur me këtë.

Pikë vijuese e rendit të ditës është – Shqyrtimi i Projektkodit të përkohshëm penal të Kosovës.

Më lejoni t'i paraqes disa informata të cilat duhet t'i keni si deputetë.

Projektkodi penal i Kosovës, i hartuar nga Zyra ligjore e UNMIK-ut i është proceduar Kuvendit përmes Qeverisë së Kosovës më 11 prill 2003. Komisioni për çështje gjyqësore, legjislacion dhe kornizë kushtetuese, si komision funksional dhe referues, ka shqyrtuar dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me amendamentet e propozuara në këtë Projektkod.

Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve, si komision i interesuar, në raportin drejtuar Kuvendit, ka theksuar se ky Projektkod nuk cenon të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Prandaj, për ta arsyetuar dhe përforcuar raportin dhe amendamentet e propozuara, lus zotin Kolë Berisha, si ushtrues apo nënkryetar i parë i Komisionit, që t'i japë vërejtjet e veta parimore.

KOLË BERISHA:

I nderuar kryetar, të nderuar kolegë deputetë, të nderuar ministra,

Duke debatuar, por shpresoj dhe besoj se edhe duke dhënë pëlqimin për miratimin e Projektkodit penal të Kosovës dhe të Projektkodit të procedurës penale të Kosovës, ky Kuvend sot po rrumbullakson punën mjaft të suksesshme mëse trevjeçare të ekspertëve kosovar dhe atyre ndërkombëtar në hartimin e këtyre dy aktligjeve shumë të rëndësishme dhe jetike për Kosovën.

Në literaturën dhe praktikën juridike, pas kushtetutës, përngja lënda që shtjellojnë dhe përngja fusha që sanksionojnë, kodi penal dhe ai i procedurës penale shpeshherë konsiderohen si aktet më të rëndësishme të një vendi dhe të një shoqërie. Për Kosovën dhe kosovarët këto dy kode kanë një rëndësi të veçantë edhe për faktin se me miratimin dhe hyrjen e tyre në fuqi Kosova, për herë të parë, po shkapet njëherë e përgjithmonë nga praktika e aplikimit të të ashtuquajturave ligje të aplikueshme të një kreature që më nuk ekziston dhe në mënyrë krejtësisht të pavarur, me një rregullativë që në vete përmban specifikat e vendit ku zbatohen, pra të Kosovës, por duke i kombinuar ato edhe me përvojat e shteteve më të përparuara të kësaj fushe, rregullon dhe sanksionon këtë materie shumë komplekse dhe shumë të ndieshme, do të thojë - të domosdoshme për këtë fazë.

Duke u nisur nga pesha dhe roli që kanë këto dy akte, si dhe nga kompetencat që dalin nga Rregullorja mbi punën e përkohshme të Kuvendit, Komisioni për çështje gjyqësore, legjislacion dhe kornizë kushtetuese i këtij Kuvendi, në mbledhjet e tij të mbajtura më 25 dhe 29 prill dhe 5, 6 e 7 maj 2003, duke shfrytëzuar edhe prezencën e bashkëhartuesve të këtyre teksteve, profesor doktor Ismet Salihut dhe profesor doktor Ejup Sahitit, ka shqyrtuar, analizuar dhe zbërthyer deri në detaje 360 nenet e Projektkodit penal dhe 556 nenet e Projektkodit të procedurës penale.

Vlenë të theksohet se për t'i dhënë opinionet e tyre rreth këtyre dy projektcodeve, pos bashkëhartuesve, kemi ftuar dhe kemi shfrytëzuar edhe prezencën dhe angazhimin shumë të çmuar të dy përfaqësuesve të Zyrës ligjore të UNMIK-ut, zbatuesit e drejtpërdrejtë në praktikë të këtyre dy kodeve, siç janë përfaqësuesit e Gjykatës Supreme të Kosovës dhe atë të Prokurorisë së Qarkut, pastaj Shërbimin juridik të Kuvendit të Kosovës dhe atë të Zyrës së Kryeministrit, të cilët do të doja që edhe sot nga kjo foltore t'i përëshëndetja dhe falënderoja për gjithë punën që kanë bërë dhe ndihmën që na dhanë dhe në veçanti do të falënderoja Zyrën Amerikane në Prishtinë, e cila, jo vetëm që mori pjesë dhe përcolli një pjesë të punës sonë, por shfaqti gatishmërinë që përmes ekspertëve të saj të na ofrojë ndihmë juridike dhe teknike.

Të nderuar kolegë deputetë,

Se këto dy tekste janë hartuar me një përkushtim dhe profesionalizëm të rrallë, dëshmon edhe fakti se as ekspertët dhe profesionistët që i konsultuam e as ne si Komision nuk patëm shumë vërejtje dhe, siç keni mund të vëreni nga amendamentet që keni përpara, është një numër shumë i vogël i ndërhyrjeve dhe shpresojmë se edhe zoti Shtajner dhe Zyra e tij ligjore do t'i ketë parasyshë, t'i marrë në konsideratë dhe t'i pranojë si të tilla.

Duke lënë hapësirë edhe për debat konstruktiv, t'ju njoftoj se ndërhyerjet tona me këto amendamente, janë njëherit edhe vërejtje të vetëhartuesve të teksteve dhe të ekspertëve që morën pjesë në punën e Komisionit.

Komisioni është ndalë, sidomos në ato vërejtje apo në dy nene kryesore kontestuese, të papranueshme që përmban edhe njëri edhe projekt-kodi tjetër. Është fjala për nenin 101 dhe nenin 107, paragrafi 1 pika 25, 26 dhe 27 për të cilat ne kemi dhënë një sqarim, respektivisht kemi bërë formulimin tonë si Komision.

Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Unë do t'ju them se nuk ka diskutime në parim, nuk ka debate, mos më keqkuptoni. Nuk është shqyrtimi në parim. Prandaj, mos të hapim lëmi ku nuk kemi mundësinë e veprimit dhe të debatimit.

Kalojmë në shqyrtimin e amendamenteve të Komisionit, apo në rekomandimet që janë propozuar.

Edhe një herë të them, ka shumë kërkesa, zonja deputete. Do të thotë nuk është çështja personale... Ekziston një procedurë të cilën nuk mund ta tejkalojmë. Nuk është procedurë e rëndomt e shqyrtimit të ligjit; e shqyrtimit të parë në parim, e diskutimit apo shqyrtimit të dytë. Është çështje e rekomandimeve në formë të amendamenteve, që Komisioni i ka propozuar dhe të deklarohejmë a i mbështesim apo nuk i mbështesim. Urdhëroni, pasi që po këmbëngulëni...

LILJANA KENIĆ:

Poštovani predsedniče, mislim da svako od poslanika ima pravo da da preporuke na ovaj Nacrt zakona. Ukoliko mi dozvoljavate, ja bih ispred Koalicije «Povaratak» dala preporuke, za koje smatramo da su valjane i upućene Specijalnom predstavniku Generalnog sekretara pre nego da objavi ovaj krivični zakon. Tražim dozvolu!?

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju lutem, unë isha i qartë. Mendimet individuale nuk janë të mundshme dhe Dragisha pyeti, dhe nuk është procedurë e re, prandaj unë ju dhash fjalën që të mos më keqkuptoni.

LILJANA KENIĆ:

Jedna ispravka. Zakon, ovaj zakon, ne donosi Skupština, dakle ne može u formi amandmana da ide, nijedna preporuka pa čak ni Komisije za pravosuđe, jer sam ja taj član te Komisije i bilo je različitih mišljenja. Obzirom da ovaj zakon pripremljen od strane Specijalnog

predstavniku odnosno UNMIK-a, on ga i donosi. Mi možemo da dajemo samo preporuke i zašto bi nam to pravo bilo uskraćeno, molim vas. Hvala! Ako smatrate da treba da damo naše preporuke prozovite me. Ja sam se prijavila.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Jo, ju falemnderit në pjesëmarrje. Urdhëroni, shefi i Grupit parlamentar.

BUJAR DUGOLLI:

I nderuar kryetar, të nderuar deputetë,

Pasi që këto dy kode kanë rëndësi, të them edhe politike edhe profesionale, juridike, penale e tjera, mendoj që deklaratimet e grupeve parlamentare, para se të qiten amendamentet në votim, janë një proces konform procedurave të Kuvendit. Më lejoni që t'i them disa qëndrime dhe atë pse këto qëndrime nuk bien ndesh me atë punën që ka bërë Komisioni sepse ne vonë jemi njoftuar me shkresat që i ka dërguar Komisioni, por sidoqoftë disa qëndrime të Grupit tonë do t'i them që tani.

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, parashtrimin në shqyrtim të këtyre dy kodeve penale të procedurës penale, e konsideron si një të arritur të madhe për proceset politike, juridike dhe për zhvillimin e institucioneve të Kosovës.

Me aprovimin e këtyre dy kodeve, ndërpritet puna e të ashtuquajturve ligje të aplikueshme penale të ish sistemit serb e jugosllav.

Ne mendojmë se nuk ka qenë e nevojshme vonesa që i është bërë aprovimit të këtyre dy kodeve si ligje bazike të Kosovës.

Para tri vitesh ka filluar puna e ekspertëve tanë dhe atyre ndërkombëtar për hartimin e këtyre kodeve dhe ne shfrytëzojmë këtë rast që t'i falënderojmë ekspertët kosovar si dhe ekspertët ndërkombëtar të cilët kanë sjellë elemente shumë të reja avancuese bashkëkohore në fushën penale dhe juridike, të cilat elemente nuk kanë ekzistuar në ligjet e mëparshme.

Puna e ekspertëve është vërtetë për çdo lavdatë dhe duhet të jetë shembull edhe për ekspertët tjerë të lëmive të ndryshme që në mënyrë profesionale t'i ndihmojnë institucionet e reja të Kosovës.

Gjatë rrugëtimit të këtyre dy kodeve, kanë ndodhur edhe disa deformime, që janë të natyrës profesionale dhe politike, por kuptohet pa vullnetin e ekspertëve.

Vërejtjet e Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës në këto dy kode kanë të bëjnë me: emërtimin, mocionin e përcaktimit të kufirit dhe vijës kufitare si dhe masat ndëshkuese për cenimin e integritetit territorial të Kosovës.

Ne mendojmë se emërtimi i kodeve, me termin "i përkohshëm" është i panevojshëm dhe propozojmë të fshihet. Mendojmë se kjo është edhe në përputhje me...

Ndërsa, neni 107, pika 25... Janë të përfshira, por një mbështetje dhe në emër të Grupit tonë parlamentar. Ne mendojmë se masat ndëshkuese, që parashihen ndaj atyre që cenojnë tërësinë territoriale të Kosovës, duhet të figurojnë dhe është e pakuptimtë pse është heq kjo masë ndëshkuese. Unë, sa vërejtja, - në materiale të Komisionit, Komisioni ka paraparë këtë dhe ne e mbështesim.

Pra, duke përfill vërejtjet që i thash dhe vërejtjet që janë në Komisionin për çështje legislative-kushtetuese, Grupi ynë parlamentar iu jep mbështetje këtyre amendamenteve dhe do t'i votojë. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit, zoti Dugolli.

Fjalën e ka shefi i Koalicionit "Kthimi" Dragisha Kërstoviq.

DRAGIŠA KRSTOVIĆ:

Gospodine predsedniče, osim što imate veoma odgovornu funkciju, imate i veoma težak zadatak da u ovakvim uslovima rukovodite radom Skupštine i da u svakom trenutku donosite ispravne odluke. Ja vas, naravno, razumem ali vas i stovremeno molim da sačuvate i svoje dostojanstvo i dostojanstvo ovog Parlamenta i da pokušate da omogućite svima, a naročito parlamentarnim grupama da iznesu svoje stavove o pitanjima koja su na dnevnom redu skupštine.

Ja ću, naravno, vrlo kratko da ukažem, da iznesem neke načelne primedbe na privremeni Nacrt krivičnog zakona i na privremeni Nacrt zakona o krivičnom postupku i da podsetim ovaj Parlament na Rezoluciju Saveta Bezbednosti Ujedinjenih Nacija 1244 koja potvrđuje podršku svih država članica tog Saveta o suverenitetu i teritorijalnom integritetu savezne republike jugoslavije, dakle bivše, odnosno sada zajednice Srbije i Crne Gore.

Mi iz Koalicije «Povratak», zaista, nikada nikome nismo ni zviždali niti smo pokušavali bilo koga da ometamo u onome što treba da kaže. Onda kad se ne slažemo, mi to izrazimo na jedan dostojanstven i način dizanjem ruke – sa ovim se ne slažemo, sa ovim se slažemo i tako dalje.

Dakle, mi mislimo da će se donošenjem, naročito zakona o krivičnom postupku, za jedan deo te teritorije, od bilo koga pa i od Specijalnog predstavnika Generalnog sekretara Ujedinjenih nacija, da to predstavlja povredu tog suvereniteta i tog teritorijalnog integriteta koji je garantovan Rezolucijom.

Ja znam da Koalicija »Povratak« verovatno neće moći da u ovom Parlamentu obezbedi većinu za svoj stav u vezi sa ovim, ali će svakako svoje obrazloženo mišljenje o ovome dostaviti Specijalnom predstavniku Generalnog sekretara.

Koalicija «Povratak» strahuje da i ovo nije jedan u nizu onih poteza domaćih ili međunarodnih institucija koje Kosovo i metohiju polako ali sigurno vode ka nezavisnosti. Nadam se i očekujem da će Specijalni predstavnik Generalnog sekretara da respektuje i ono što bude Koalicija «Povratak» napisala. Koliki će taj respekt biti, videćemo. Ovo je dakle jedan naš stav.

Zakoni, koji se razmatraju, su inače, po svojoj pravno-tehničkoj strukturi, savremeni. Obezbeđuju mogućnost da zaštite ljudska prava i slobode kao i da jednom društvu obezbede zaštitu od kriminala svake vrste. I kao takvi, zaslužuju visoku ocenu. Tu nema dileme. Ali, podržavam mišljenje moje kolegenice Liljane Kenić, da na ove zakone, na ove privremene nacрте ovih zakona, ne možemo davati nikakve amandmane, jer to uostalom nije moguće, ali je moguće da se daju preporuke i sugestije koje će Specijalni izaslanik da uvaži ili da ne uvaži.

Ali, još jednom ponavljam, donošenje privremenog zakona o krivičnom postupku i od strane Specijalnog izaslanika Generalnog sekretara, izaziva strah kod Koalicije «Povratak» i kod Srpskog naroda od onoga što se zove - nezavisnost i put ka nezavisnosti Kosova. Hvala lepo.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. E ka fjalën shefi i Grupit Parlamentar të LDK, Sabri Hamiti.

SABRI HAMITI:

Ju falemnderit, zoti kryetar. Deputetë të çmuar e të nderuar,

Flas në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës. Ne edhe në bisedimet e brendshme, edhe në bisedimet me partnerët tanë ndërkombëtar, ka një vit e gjysmë që flasim dhe kërkojmë që në mesin e ligjeve prioritare për Kosovën, që janë të domosdoshme për funksionalizimin demokratik të saj, do të ishin kodi penal dhe kodi për procedurë penale, si dhe ligji për pronat. Ne jemi të gëzuar dhe ndiejmë satisfaksion të madh që më në fund këto

dy ligje, pra kodi penal dhe kodi për procedura penale janë hartuar, kanë kaluar nëpër zyrat ndërkombëtare dhe përfundimisht kanë arritur në banga të Parlamentit për dhënien e pëlqimit.

Me këtë rast, deklaroj që ne kemi studiuar edhe vërejtjet e Komisioni konkret legjislativ dhe kornizë kushtetuese dhe ne do t'i përkrahim nxjerrjet e ligjeve dhe do t'i përkrahim rekomandimet shumë të studiara të Komisionit të përmendur.

Vetëm të them edhe një fjalë që këto ligje nuk paragjykojnë statusin e Kosovës, por krijojnë kushte për mbrojtje të lirisë së individëve dhe kushte për sigurinë.

Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit shumë, zoti Hamiti.

Unë do t'ju lutja për një atmosferë të qetë dhe pune. Po përsëris, duhet të heqet nga procesverbali deklarata politike e Partisë Demokratike të Kosovës. Kjo është e drejtë dhe vendim imi, prandaj apeloj që grupet tjera parlamentare, herave tjera, me të drejtë të plotë të kundërshtojnë dhe protestojnë, por jo me një fjalor të tillë, i cili do t'na kthente një shekull prapa. Zotin Kërstoviq, e falënderoj për kontribut, por Sabri Hamiti e tha pikërisht

shkëlqyeshëm: – me këtë hap, ne mundohemi që të mbrohen të drejtat, liritë dhe çdogjë inviduale në Kosovë. Prandaj, ju lutem, të mos hapim debat. E ka fjalën zoti Meta.

HASAN META

T'falemnderit zoti kryetar, të nderuar deputetë,

Unë, në parim, dola këtu t'i them dy-tri fjalë për incidentin që ka ndodhur. Më falni, vetëm pak! Ju lutem. Kishte me qenë mirë që si Kuvend, ndonjë komision që është për etikë, për moral apo të ngjashëm, ju lutem më falni... Nuk mund të paraqitemi këtu gjëja që s'ka ndodhur kurgjë. Dëgjuam deklaratën, nuk është me rëndësi ajo, por si Parlament, duhet ta dënojmë një akt të tillë, i cili nuk përshkon me moralin e deputetit dhe me të gjitha të tjerat dhe etikën që duhet të mbizotërojë këtu në Kuvendin e Kosovës. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit shumë.

Unë në fillim thash se do të procedohet sipas rregullave në fuqi. Edhe një sqarim për ata që nuk kanë qenë të informuar dhe po shoh se një grup i madh i deputetëve nuk ka qenë i informuar. Puna e sotme është punë e gjatë e marrëveshjeve të Parlamentit, e letrave, e debateve, e diskutimeve si të krijojmë një unitet veprues bashkërisht institucionet e Kosovës dhe ato të UNMIK-ut dhe rezultat i asaj është një punë shumë e madhe që ka bërë komisioni, prandaj asnjë debat më.

Kalojmë në shyrtimin e amendamenteve veç e veç:

1. Miratimi i amendamenteve për Projektkodin penal.

Amendamenti 1, Në emërtimin e këtij Projektkodi të heqet fjala “i përkohshëm”.

Kush është për? Ju falemnderit shumë.

Kush është kundër? Le të numërohen votat “kundër” me saktësi, ju lutem. 9 janë kundër.

Si deputet, je kundër, a?

Kush abstenon nga votimi? Nuk abstenon askush.

Konstatohet se miratohet amendamenti i propozuar.

Amendamenti 2, Neni 1, paragrafi 3, rreshti i tretë, në vend të fjalës “ndiqet” të jetë fjala “akuzohet”.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Le të numërohen votat “kundër” ju lutem. 10 vota kundër.

A abstenon ndokush nga votimi? Askush.

Miratohet amendamenti i propozuar.

Amendamenti 3 Neni 3, paragrafi 1, pas pikës 1: “Dënimet kryesore” të jenë “dënimet alternative” dhe vazhdohet ...

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Ju falemnderit. 10 vota kundër.

A abstenon ndokush nga votimi? Askush.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 4, Neni 20, paragrafi 2, Teksti në shqip nuk është në harmoni me atë në anglisht, ku thuhet: “më së paku 5 vjet”, prandaj Komisioni propozon “më së paku 3 vjet”.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? 10 vota kundër.

A abstenon kush nga votimi? Askush.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 5, Neni 22, paragrafi 1, duhet të jetë “vullnetarisht dhe përfundimisht”.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? 10 janë kundër.

A abstenon ndokush nga votimi? Askush.

Amendamenti miratohet.

Amendamenti 6, Neni 23, fjala “bashkërisht” shlyhet.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? 10 janë kundër.

A abstenon kush nga votimi? Askush.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 7, Neni 24, të jetë “kushdo që me dashje shtyt tjetrin të kryejë vepër penale dënohet me $\frac{3}{4}$ e maksimumit të dënimit të paraparë”.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? 10 vota janë kundër.

A abstenon ndokush? Askush.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 8, Neni 28, paragrafi 6, pas fjalës “nëse” shtohet fjala “botuesi”.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? 10 vota janë kundër.

A abstenon ndokush nga votimi? Askush.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 9, Neni 34, paragrafi 1, pika 1, në vend të fjalës “të përmbajë” të jetë fjala “të parandalojë”.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? 10 kundër.

A abstenon ndokush nga votimi? Askush.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 10, Neni 55, fjalët “më së paku 5 vjet burgim” të zëvendësohet me fjalët: “më së paku 3 vjet burgim”.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? 10 kundër.

A abstenon ndokush nga votimi? Askush.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 11, Neni 99, fjalët “ligje penale” zëvendësohen me fjalët “legjislacion penal i Kosovës”. Kështu të veprohet edhe në nenet 100, 101 dhe 102 të këtij Projektkodi.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? 10 kundër.

A abstenon kush nga votimi? Askush.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 12, Neni 101, paragrafi 2 shlyhet në tërësi.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? 10 kundër.

A abstenon ndokush nga votimi? Askush.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 13, Neni 106, fjalët “përgjegjësia penale e personit juridik” zëvendësohen “përëgjegjësia e personave juridikë për vepra të kryera penale”.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? 10 vota kundër.

A abstenon ndokush nga votimi? Askush.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 14, Neni 107, pika 1, paragrafi 25, të ndryshohet dhe të jetë: “shprehja territori i Kosovës do të thotë sipërfaqja tokësore dhe sipërfaqet ujore brenda kufijve të saj si dhe hapësira ajrore mbi të”, ndërkaq pika 26 dhe 27 të këtij neni të shlyhen në tërësi.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? 9 kundër.

A abstenon ndokush nga votimi? Askush.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 15, Neni 108, në vetë titullin e nenit, pas fjalës “kundër” të shtohet fjala “sigurisë” dhe të formulohet “Veprat penale kundër sigurisë së Kosovës dhe banorëve të sajë”.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? 10 kundër.

A abstenon ndokush nga votimi? Askush.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 16, Pas nenit 108 të shtohet neni i ri me këtë titull “Rrezikimi i integritetit territorial” dhe të riformulohet me: “Kushdo që tenton, duke përdorur dhunën apo kërcnimin se do të përdorë dhunën, të rrezikojë integritetin territorial të Kosovës dënohet së paku 5 vjet burgim” dhe numërimi i neneve vazhdon të prijë për një numër.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? 10 kundër.

A abstenon ndokush nga votimi? Askush.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 17, Neni 114, paragrafi 1 dhe 2, fjala “prej” zëvendësohet me fjalën “deri”.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? 10 kundër.

A abstenon ndokush nga votimi? Askush.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 18, Neni 155, të ndryshohet titulli dhe në vend të “rrahja” të jetë pjesëmarrja në “rrahje”.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? 10 kundër.

A abstenon ndokush nga votimi? Askush.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 19, Neni 245, para fjalë “shenjat e etiketave” të jetë “prodhimi, përdorimi apo ndryshimi i shenjave të etiketave”.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? 10 kundër.

A abstenon kush nga votimi? Askush.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 20, Te numërimi i veprave penale, “deklarimet e rrejshme” është gabim në tekstin e gjuhës shqipe dhe në vend të”nenit 302” duhet të jetë “neni 309”.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? 10 kundër.

Miratohet amendamenti.

2. Komisioni i propozon Kuvendit miratimin e këtyre sygjerimeve.

Në kapitullin 13, propozohet të jenë edhe inkriminimet e këtyre veprave: “kryengritja e armatosur; dërgimi dhe transporti në territorin e Kosovës i grupeve të armatosura; veprën penale të sabotimit dhe veprën penale të spiunazhit”.

Kush është për? Ju falemnderit.

Kush është kundër? 10 kundër.

A abstenon kush nga votimi? Askush.

Konstatoj se miratohet ky sygjerim.

Dhe, në fund, më lejoni që t’ju ftoj ta votojmë në tërësi Ligjin e ndryshuar dhe të amendamentuar.

Kush është për? Ju falemnderit shumë.

Kush është kundër? 10 kundër. Ju falemnderit.

A abstenon ndokush nga votimi? Askush.

Konstatoj se u aprovua Ligji i ndryshuar dhe i amendamentuar.

Votimi – Glasanje – Voted:

Për – Za – For:Shumica – Veçina – Majority.....

Kundër – Protiv – Against 10

Abstenime – Uzdržanih – Abstained 00

(Duartrokitje)

Vazhdojmë me rendin e ditës – **Shqyrtimi i Projektkodit të përkohshëm të procedurës penale të Kosovës.**

Vlenë i njëjti arsytim dhe fjalët hyrëse si më parë dhe arsyetimet e Komisionit janë:

1. Miratimi i Projektkodit të përkohshëm të procedurës penale të Kosovës me këto amendamente:

Amendamenti 1, Në emërtimin e këtij Prjektkodi, të hiqet fjala “i përkohshëm”.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? 10 kundër.

A abstenon kush nga votimi? Askush.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 2, Neni 11, paragrafi 1, në fillim të fjalisë në tekstin shqip “që nga marrja” të zëvendësohet “me rastin e marrjes”, ndërsa teksti anglisht është në rregull.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? 10 kundër.

A abstenon kush nga votimi? Askush.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 3, Neni 21, paragrafi 1, nënparagrafi 2 dhe neni 23, paragrafi 1, nënparagrafi 3, në të dy këto paragrafe të këtyre neneve fjala “unike” të zëvendësohet me fjalët “jo të rëndomta”.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? 11 kundër.

A abstenon ndokush nga votimi? Askush.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 4, Neni 100, paragrafi 2, në tekstin në anglisht, fjalës “klerk” t’i shtohet fjala “rikording”, kurse “është” në tekstin shqip të Projektkodit të procedurës penale “procesmbajtësi”.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? 11 kundër.

A abstenon kush nga votimi? Askush.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 5, Neni 228, nënparagrafi 1, me një kllapë – fshihet, ndërsa nënparagrafi 2, me një kllapë – mbetet.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? 11 kundër.

A abstenon kush nga votimi? Askush.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 6, Neni 233, paragrafi 4, “koha e arrestit në 72 orë” të zëvendësohet me “48 orë”.

Kush është për? Ju falemnderit.

Kush është kundër? 11 kundër.

A abstenon kush? Askush.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 7, Neni 348, paragrafi 2, si në tekstin shqip fjala “mund” të jetë e njëjtë edhe në tekstin anglisht ku është “duhet”. Domethënë edhe në tekstin anglisht “duhet” të jetë fjala “mund”.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? 11 kundër.

A abstenon ndokush? Askush.

Miratohet amendmaneti.

Në fund, më lejoni ta vë në votim Ligjin në tërësi, me këto amendamente.

Të pranishëm janë 71 deputetë.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? 11 kundër.

A abstenon ndokush? Askush.

Konstatohet se u miratua Ligji me amendamentet e propozuara.

Votimi – Glasanje – Voted:

Për – Za – For.....Shumica – Vecina – Majority...

Kundër – Protiv – Against 11

Abstenime – Uzdržanih – Abstained..... 00

(Duartrokitje)

Tani do ta bëjmë një pauzë prej afër 30 minutash.

(Vijon pauza)

===

(Pas pauzës, seanca vazhdoi punën)

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Të nderuar deputetë, po vazhdojmë punën.

Mendoj se kemi kourimin e nevojshëm për punë, ndërsa Sekretaria ta kryejë punën e vet dhe të pranishmit, në fund, siç jemi marrë vesh, jo në fillim të shënohemi e pastaj të shkojmë në punë të dorës së tretë, të katërtë, prandaj ju lus të keni kujdes dhe vendimi le të respektohet.

Urdhëroni, Fatmir Rexhepi, para se të vazhdojmë me rend të ditës.

FATMIR REXHEPI:

I nderuar kryetar, të nderuar deputetë, duke kërkuar falje, dua t'ju njoftoj se sot, nga shërbimi i Kuvendit, nga ajo që është protokolluar në dokumente, mora një letër me të cilën do t'ju njoftoj se çka shkruan:

“Merr, Fatmir Rexhepi, deputet i Parlamentit të Kosovës,

Nga armata kombëtare shqiptare, me numër e protokolluar, e nënshkruar nga kryeshefi i ekzekutivit Kostaç Tushi, me vulë, me tëra, në të cilën thuhet: që duhet të heqësh dorë nga aktiviteti yt si deputet, si anëtar i Kryesisë së LDK, përndryshe vdekja të pretë ty dhe kolegët tjerë.”

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Mendoj se duhet të vazhdojmë dhe në të njëjtën kohë, ata që mendojnë të papërgjegjshëm me raste individuale, të shihet sa e lehtë, në fakt, sa e vështirë është puna në institucione, sa përgjegjësi kemi individuale dhe kolektive. Andaj, çështjet personale, që nganjëherë tërhiqen e zvarriten nga e kaluara, është lutje shumë e madhe imja që të mos manifestohen në institucione.

Po vazhdojmë punën.

Rekomandimi i Komisionit për buxhet lidhur me vërejtjet e UNMIK-ut në Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi.

Do t'ju lutja që të jemi të qetë, të dëgjojmë mirë dhe në një mënyrë konstruktive t'i aprovojme ato çështje që janë studiuar kohë të gjatë nga komisionet përkatëse dhe në të njëjtën kohë, ju lus të gjithëve, aty ku sponzori i ligjit, do të thotë Qeveria ka po ashtu ndonjë rekomandim ose lutje, të jemi shumë të përgjegjshëm dhe vërtetë të mundohemi maksimalisht t'i aprovojme, tejkalojmë dhe të dalim në një mënyrë rezultativë.

Prandaj, Komisioni për buxhet, në mbledhjen e mbajtur më 29 prill 2003, shqyrtoi vërejtjet e UNMIK-ut në Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi dhe lidhur me këtë deputetëve të Kuvendit të Kosovës iu propozon këtë

R e k o m a n d i m

Komisioni, pas shqyrtimit të vërejtjeve të UNMIK-ut në Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi, i propozon Kuvendit të Kosovës që t'i miratojë këto amendamente:

Amendamenti 1, Neni 17.4 zëvendëson frazën "sekretariati i KEF-it do të" pasi që ka marrë udhëzim dhe direktiva nga PSP me "PSSP Këshillin e KEF-it".

Kush është për këtë amendament, le të deklarohej?

Nuk ka debat, por si shef i Grupit Parlamentar mund të merrni fjalën.

BUJAR DUGOLLI:

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës ka konsideruar edhe më herët dhe vazhdon të konsiderojë si metodë të papranueshme mosnënshkrimin e këtyre ligjeve nga PSSP.

Me kurrfarë procedure, as në bazë të Kornizës kushtetuese, as të Rregullores së punës të Kuvendit, nuk mund të vjen një procedurë, dmth. e tillë, e të bëhen rekomandime për ligjet të cilat i kemi votuar një herë.

Ne nuk do të marrim pjesë në këtë votim, do të jemë prezent në sallë, por nuk do të votojmë për këto rekomandime sepse është e panevojshme. Ne i kemi miratuar ligjet, i kemi nënshkruar. Është procedurë e veçantë pas nënshkrimit të ligjeve nga PSSP që Kuvendi t'i marrë në shqyrtim dhe është e drejtë e Përfaqësuesit Special, në bazë të akteve normative ekzistuese që të ndërhyjë kur ka konsideruar ai që është bërë ndonjë shkelje. Kështu që nuk e shohim të nevojshme të votojmë për këtë, sepse do të shkelim mbi ato parime që i kemi votuar më herët. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit, zoti Dugolli. Dragisha Kërstoviq, si shef i Grupit Parlamentar "Kthimi".

DRAGIŠA KRSTOVIĆ:

Gospodine predsjedniče, dame i gospodo poslanici,

Koalicija «Povratak» će, između pragmatizma, koji je naveden kao glavni razlog ponovnog uvrštavanja u Skupštinsku proceduru ovih zakona i legalizma, da se opredelji ovom prilikom

za legalizam. Mi çemo, naravno, glasati protiv jer jednostavno smatramo da nijednim aktom, prema tome, dakle, ni Ustavnim okvirom, ni Poslovníkom, za koji, nažalost, ne znamo koji je na snazi – onaj prvi ili ovaj zadnji, mi çemo glasati protiv.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Muhamet Kelmendi, mos të veçoj, pasi edhe Hasani e muar fjalën pak më parë.

MUHAMET KELMENDI:

I nderuari zoti kryetar, zonja dhe zotërinj,

Natyrisht, përkrah mendimin e Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, se ligjet, të cilat ky Kuvend i ka miratuar, është jologjike, jo e drejtë dhe amorale për anëtarët e këtij Kuvendi që të kthehen në rishqyrtim dhe njëherit ne përsëri të merremi me ato ligje për të cilat kemi shprehë vullnetin, jemi pajtuar dhe dakorduar.

Unë mendoj se çështja duhet shtruar krejtësisht ndryshe. Të gjitha këto katër ligje, është dashur nga zoti Shtajner të nënshkruhen, e në qoftë se jo, atëherë ky Kuvend ka patur mundësi të veprojë duke u mbështetur në Kornizën ligjore të Kosovës në nenin pikërisht të përcaktuar këtu, ku thuhet se “në raste të jashtëzakonshme dhe në veprime të veçanta, ka të drejtë, edhe pa nënshkrimin e Shtajnerit ligjet e tilla të bëhen të plotëfuqishme”, është mundësia e parë. Dhe, e dyta, ka dashur, për mendimin tim, ky Kuvend, që me kohë t’i qaset procedurës për

ndryshimin e disa amendamenteve të Kornizës kushtetuese, në mënyrë që, ligjet e nxjerra nga ky Kuvend, të shpallen nga kryetari i Kosovës apo nga kryetari i këtij Kuvendi me ditën e aprovimit nga ana e këtij Kuvendi e jo të zvarriten dhe pastaj, pas muajve të tërë, të kthehen në këtë Kuvend dhe të paraqesim Kuvendin jolegjitim, jo të aftë, jo të nivelit të detyrës së kryerjes së punëve dhe ne të bëhemi objekt i diskutimit tek qytetarët e Kosovës. Sepse, të gjithë e dinë se këto katër ligje, ne të gjithë me vota, i kemi aprovuar, të gjithë qytetarët e dinë se ne jemi Parlament i Kosovës, përfaqësues të tyre dhe tani të vijnë këto përsëri, dhe atëherë del pikëpyetja e qytetarëve tanë të thotë: kemi të bëjmë, pra, me një parlament që s’ka kompetenca, që s’ka autorizime, që s’ka përgjegjësi. Dhe, natyrisht, në zgjedhjet e ardhshme, me një kornizë të tillë kushtetuese nuk do të kemi sukses të ecim përpara në zgjidhjen e detyrave që i kërkon shoqëria jonë.

Prandaj, mendoj që ligjet e tilla të mos procedurohen sot, por ashtu të aprovuara, të kthehen tek zoti Shtajner, ndërsa ne të shkojmë kah administrimi dhe nxjerrja e një neni të veçantë të Kornizës kushtetuese ku do të thuhej se “shtatë ditë, pas aprovimit nga Kuvendi, nga kryetari i Kosovës ligjet e tilla të shpallen të plotëfuqishme”. Pas shtatë ditëve, nëse nuk shpallet një ligj i tillë, atëherë Kuvendi të njëjtin ligj e shpall të plotëfuqishëm. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Vazhdimisht po duhet ta korigjoj veten. Po më vjen shumëmirë që Muhameti gradualisht po i kthehet amës së vet, Grupit Parlamentar të Aleancës dhe do të kemi më pak grupe parlamentare dhe është e drejtë juaja.

Krejt këto opsione kanë qenë disa herë në shqyrtim, edhe në Kryesi. E vetmja zgjidhje pragmatike, prandaj unë e kuptoj edhe Dragishën edhe juve, por ju lutem ka çështje shumë më të mëdha se fërkimet e këtilla.

Ne duhet ta bëjmë një punë normale parlamentare dhe nuk është përjashtim – një ligj i cili nuk konsiderohet q ë është rezultativ, mund të amendamentohet. Ne nuk kemi pranuar mënyrë tjetër, por mënyrën parlamentare dhe kështu është punuar dhe kështu do të vazhdojmë.

Kush është për amendamentin 1, që e lexova, ju lutem të deklaroheni.

Ju falemnderit. Shihet se është shumica absolute është për.

Kush është kundër? 13 kundër.

A abstenon ndokush nga votimi? Askush.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 2, Neni 20, në titull, të fshihen fjalët “Qeveria dhe KEF-i” dhe zëvendësohen me këtë në vijim, siç i keni të propozuara...

Kush është për këtë propozim të Komisionit? Ju falemnderit.

Kush është kundër? 13 kundër.

A abstenon ndokush nga votimi? 7 abstenime.

Miratohet amendamenti.

Ju lutem, kush është për **Ligjin e amendamtuar**? Ju falemnderit.

Kush është kundër? 13 kundër.

A abstenon ndokush nga votimi? Një abstenim.

Konstastoj se Ligji i amendamentuar, është aprovuar dhe i uroj Ministrisë së Financave që të kryen punën e vet.

Votimi – Glasanje – Voted:

Për – Za – For.....Shumica – Veçina – Majority.....

Kundër – Protiv – Against13

Abstenuan – Uzdržanih – Abstained.....01

(Duartrokitje)

Pika e pestë: **Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për transport dhe telekomunikacion për amendamentimin e Ligjit për telekomunikacion.**

Komisioni për transport dhe telekomunikacion, në mbledhjen e mbajtur më 2 prill 2003 si dhe në mbledhjen e datës 23 prill 2003, në përbërje trepalëshe: Komisioni, Ministria dhe Zyra Ligjore e PSSP, pas harmonizimit të qëndrimeve, vendosi t'i

R e k o m a n d o j ë

Propozimndryshimet, si vijon:

Urdhëroni, Nojkiq.

RANDEL NOJKIĆ:

Mislim, gospodine predsedavajući, da vam ta ironija nije potrebna. Ovaj..., ja sam se javio, pre svega, u skladu sa Poslovníkom, s obzirom da sam drugi predsedavajući Komisije za transport i komunikacije i mislim da mi po tom osnovu pripada pravo da govorim o ovoj tački s obzirom da je to preporuka Komisije i mislim da bi trebalo da neko, meni je žao što predsedavajući nije ove Komisije tu i da on obrazloži.

No, međutim, ja sam se upravo iz tog razloga javio i na početku ove plenarne sednice kada je u pitanju dnevni red. Vi mi niste dali reč, poštujući neka svoja pravila, razumete, da nekim poslanicima ipak date reč a nekim u opšte ne dajete, te mislim da to apsolutno nije u redu i da to je zaista jedna diskriminacija poslanika Koalicije «Povratak» u ovom Parlamentu.

Molim vas! Ovo su vrlo važne stvari i mislim da ne bi trebali ovako da se ponašamo. Pre svega, ovde je bitno prekršeno pravilo 9.1.39. i ova procedura nije ispoštovana kako treba. S obzirom da su predstavnici Koalicije «Povratak» u roku od 48 sati, nakon pošto je izglasan ovaj Zakon u Skupštini, u ložili prigovor sa potpisom svih 22 poslanika, mi smo trebali, u određenom roku, da dobijamo odgovor. Mi nismo dobili odgovor. Znamo za problem da nije služba Sekretarijata dostavljala to, pa mi smo dostavljali te svoje primedbe i gospodinu Štajneru, odnosno Kancelariji SPGS. Te, prema tome, mislim da ova druga procedura nije mogla da se sprovede pre nego što se ispoštovala ova prva procedura da dobijamo odgovor. To je prva stvar.

Druga stvar: Mi smo na poslednjoj sednici Komisije za transport i komunikacije, konstatovali i doneli odluku – zajedničku, jer smo konstatovali to i ranije, da sve tri verzije Nacrta zakona nisu bili usaglašene. Tu ima bitnih razlika. I ne može da se glasa o tri zakona koji imaju različita značenja, jer su značajne razlike.

Komisija je donela odluku da se usaglase, te prema tome, mislim da je taj nacrt zakona trebao da se usaglasi, pa da se vrati i da se onda celokupna procedura sprovede kako se sprovela. Znači, i uprkos činjenici da je to Komisija, još jedanput ponavljam, usvojila na poslednjoj sednici, da mora da se usaglase sva tri nacrta. Te, prema tome, mislim da je to takođe povreda našeg prava da mi možemo da sastavljamo primedbe na ovaj Zakon.

Dalje, mi smo dali bitne primedbe koje se tiču interesa zajednice, ono što smo mi kao Koalicija dali i postupak je apsolutno ispoštovan, s obzirom da su amandmani dati Komisiji,

amandmani su dati Skupštini i amendmani su dati Predsedništvu i normalno Štajneru na kraju. I mi smo zaista morali da budemo, ako ništa više, i spoštovani, da dobijamo odgovore, jer kažem da su povrede veoma – veoma značajne.

Takođe na ovoj zadnjoj sednici vodio se dijalog....Pa, molim vas hoćete li da mi dozvolite da ja govorim, je li mogu da govorim?!

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Histori, amani t'qoftë, mos na mbani apo ligjerata. Jeni kryesues i Komisionit që keni bërë vërejtjet dhe në emër të saj folni për vërejtjet dhe rekomandimet e mos na ligjeroni histori.

RANDEL NOJKIĆ:

Ja govorim zato što je različit moj stav od stava Komisije. Upravo zbog toga. Molim, vas. Molim vas, pa pustite mi da kažem, molim vas! Za vreme, dok se vodio dijalog, odnosno se raspravljalo o ovim amandmanima, članovi Komisije... skoro da nije im se dozvolilo da razgovaraju, jer su samo predsedavajući Komisije, ljudi iz Vlade i iz Štajnerovog kabineta, samo su oni razgovarali. Kad su na kraju usvojili amandmane, ja sam pitao: « – A dobro, gde smo mi ostali? – Pa, ajde, sad, izvolite recite.» Te prema tome, mislim da ni procedura nije ni u samoj Komisiji ispoštovana onako kako je trebala da se ispoštuje.

I upravo, sigurno Koalicija «Povratak» neće glasati za ove preporuke ali ja sada molim onih iz međunarodne zajednice, koji posmatraju i koji vode... računa o tome kako se radi u ovom Parlamentu, da imaju u obzir i pre svega ljude iz kabineta Štajnera, da imaju u obzir da su ovde bitno povređeni i ustavni okvir, i poslovnik o radu i Skupštine, i Komisije, i molim vas da se, u tom smislu, ove preporuke ne prihvate. Hvala!

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Zoti Nojkiq, ju falemnderit. Ju lutem, të procedojmë. Dëgjuam nënkryetarin e parë a të dytë të Komisionit.

Amendamenti 1, Zyra ligjore e PSSP dhe Ministria për Transport dhe Posttelekomunikacion, të përkrahur nga Komisioni funksional, e ndryshojnë nenin 17, pika 1, rreshti 2, pas fjalës: “të cilin” fshihet teksti “identifikohet dhe lehtësohet heqja e barrierave teknike” dhe shtohet teksti “identifikohen pengesat teknike”.

Kush është për? Ju falemnderit.

Kush është kundër? 13 kundër.

A abstenon ndokush nga votimi? Një abstenim.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 2, Neni 26, pika 26, 4a), rreshti i dytë, pas fjalës “nga” fshihet teksti: “PSSP-ja apo ministria” dhe zëvendësohet me tekstin “Ministria në koordinim të ngushtë me PSSP-ën”.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? 13 kundër.

A abstenon ndokush? Një abstenim.

Amendamenti miratohet.

Amendamenti 3, Neni 26, pika 7, rreshti i dytë, pas fjalës “nga” fshihet teksti: “PSSP-ja Apo ministria” dhe zëvendësohet me tekstin “Ministria në koordinim të ngushtë me PSSP-ën”.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? 13 kundër.

A abstenon ndokush? Një abstenim.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 4, Neni 36, rreshti i parë, pas fjalës “ART-ja” shtohet teksti “në koordinim të ngushtë me PSSP-ën”.

Kush është për? Ju falemnderit.

Kush është kundër? 13 kundër.

A abstenon ndokush? Një abstenim.

Amendamenti miratohet.

Amendamenti 5, Neni 63, pika 63.1, rreshti i tretë, pas fjalës “të shërbimeve”, riformulohet teksti “ART-ja do t’u caktojë ofruesve të shërbimeve vetëm ato sa burime spektrale, të cilat në mënyrë të veçantë, janë ndarë nga PSSP-ja”. Dhe, me këtë, fjala “sa” të fshihet.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? 13 kundër.

Kush abstenon? Dy abstenojnë.

Amendamenti miratohet.

Amendamenti 6, Neni 63, pika 63.3, rreshti i dytë, pas fjalës “PSSP-ja” shtohet teksti: “të gjitha miratimet e burimeve të spektrit që do t'i caktojë ART operuesve të shërbimeve duhet të jenë të ndara nga PSSP-ja”.

Kush është për? Ju falemnderit.

Kush është kundër? 13 kundër.

Kush abstenon? Një abstenim.

Amendamenti miratohet.

Amendamenti 7, Neni 64, pika 64.1, rreshti i parë, fjala “akordim” zëvendësohet me fjalën “ndarjen”.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? 13 kundër.

A abstenon ndokush? Nuk abstenon askush.

Amendamenti miratohet.

Amendamenti 8, Neni 64, pika 64.2, rreshti i parë, pas fjalës “ART” shtohet teksti “në bashkëpunim dhe ndihmën e ofruar të PSSP-ës”.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? 13 kundër.

A abstenon ndokush? Një abstenim.

Amendamenti miratohet.

Amendamenti 9, Neni 64, pika 64.3, rreshti i parë, pas fjalës “të raportojë” shtohet fjala “PSSP”.

Kush është për? Ju falemnderit.

Kush është kundër? 13 kundër.

A abstenon ndokush? Dy abstenime.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 10, Në tërë tekstin e Ligjit për telekomunikacion, fjala “kombëtar” zëvendësohet me fjalën “Kosovës”.

Kush është për? Ju falemnderit.

Kush është kundër? 13 kundër.

A abstenon ndokush? Tre abstenime.

Miratohet amendamenti.

Dhe, para se ta vë Ligjin në tërësi në votim, pyes sponsoruesin – a dëshiron ta marrë fjalën.

Urdhëroni zoti ministër.

ZEF MORINA:

Ju falemnderit, zoti kryetar, zonja dhe zotërinj deputetë, kolegë ministra,

Në nenet 2 dhe 19 të Ligjit mbi telekomunikacionin, është përfshirë qëndrimi rreth krijimit të Bordit mbikëqyrës i cili ka për qëllim mbikëqyrjen e punëve në PTK. Qëndrimi për krijimin e

këtij bordi është rrjedhojë e propozuar nga Komisioni i Kuvendit për transport edhe telekomunikacion, nene të cilat nuk kanë qenë pjesëpërbërëse nga Ligji i proceduar nga Qeveria.

Konsideroj se Kuvendi është organ më i lartë shtetëror legjislativ dhe vendimmarrës nga i cili krijohet qeveria dhe se nuk duhet të mirret me punët e ekzekutivit.

Në bazë të Kornizës kushtetuese, Ministria është përgjegjëse për postën, telekomunikacionin e tjerë, pra edhe për PTK-ën, ndërsa Ministria duhet t'i raportojë Kuvendit jo vetëm për punët në PTK por për të gjitha çështjet të cilat janë në kompetencën e saj. Kështu që, bordi i krijuar në mes Kuvendit dhe AKM do të krijojë përzierje kompetencash në mes Ministrisë dhe Kuvendit.

Meqë AKM është një agjencion i përkohshëm, ajo nuk duhet të figurojë fare në këtë ligj, kështu që, në këto nene, qeveria propozon këto ndryshime, me këto amendamente:

Në nenin 2, ku përfshihet bordi mbikëqyrës duhet të jetë “Bordi mbikëqyrës nënkupton bordin e themeluar nga Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit për mbikëqyrjen e PTK-ës; dhe

Në nenin 19, duhet të figurojë si vijon “Ministria e Transportit dhe Posttelekomunikacionit, përmes bordit mbikëqyrës do të mbikëqyrë punët në PTK”. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Unë do të kërkoj ndihmë. Thash në fillim parimin, që sponzorin duhet maksimalisht, në këtë rast Qeveria, ta mirëkuptojë. Megjithatë, unë lus Komisionin për buxhet ta shprehë mendimin e vet.

HAKI SHATRI:

Ju falemnderit, zoti kryetar, të nderuar kolegë deputetë,

Dola këtu që ta përkrah propozimin e ministrit të Transportit dhe Posttelekomunikacionit në propozimin e amendamenteve që janë mbështetur dhe kanë mbri në Kuvend si amendamente të qeverisë. Arsyeshmëria për përkrahje përputhet plotësisht me arsyen që zoti ministër i parashtrroi para nesh.

Edhe pse Komisioni për buxhet, kësaj radhe, nuk i ka shqyrtuar këto dy amendamente, dua t'ju përkujtoj se Komisioni për buxhet, me rastin e shqyrtimit të këtij Projektligji, më 2 dhjetor 2002, ka përkrahur pikërisht zgjidhjen të cilën tani e propozoi zoti ministër dhe ishte kundër zgjidhjes së propozuar e cila tash del se është e nevojshme të korrigjohet.

Mendojmë dhe është në të dhënat e punës së Komisionit sepse Komisioni ka qenë pikërisht për formulimin që sot është propozuar dhe ekziston edhe në dokumente. Pra, kam të drejtë edhe morale të them se është edhe qëndrim i Komisionit që këto dy amendamente të përkrahen dhe iu propozoj edhe deputetëve tjerë që në këtë seancë t'i përkrahin dhe votojmë. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit, zoti Shatri. Mendoj se duhet mbështetur amendamentin e Ministrisë për Transport dhe Komunikacion.

Kush është për këtë propozim? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? 13 kundër.

A abstenon ndokush? Askush.

Do të thotë, aprovohet amendamenti i Qeverisë.

Tani ju ftoj që t'i votojmë amendamentet në tërësi.

Kush është për? Ju falemnderit.

Kush është kundër? 13 kundër.

A abstenon ndokush? Një abstenim.

Konstatoj se u miratuan amendamentet e propozuara.

Kalojmë në pikën e gjashtë të rendit të ditës: **Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për tregti dhe industri për amendamentimin e Ligjit për aktivitetet e tregtisë me jashtë.**

Komisini për tregti dhe industri, në mbledhjen e mbajtur më 29 prill 2003, në përbërje Trepalëshe: Komisioni për tregti dhe industri, Ministria përkatëse dhe Zyra Ligjor e PSSP, pas harmonizimit të qëndrimeve, vendosi t'i

R e k o m a n d o j ë

propozimndryshimet në Ligjin për aktivitetet e tregtisë me jashtë si vijon

Amendamenti 1, Në preambulë të shtohet kjo në vijim, pas paragrafit 2: “Duke marrë parasysh se dispozitat e këtij Ligji do të jenë pa paragjykime kundrejt të drejtave dhe imunitetit të UNMIK-ut e KFOR-it të nevojshëm për përmbushjen e mandatit të tyre në bazë të Rezolutës së Këshillit të Sigurimit 1244 dhe Kornizës kushtetuese; Duke riafirmuar se termet e përcaktuara në nenin 2 të këtij Ligji dhe akteve të dalura nga ky Ligj do të interpretohen në pajtim me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit 1244 dhe Kornizës kushtetuese”.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? 13 kundër.

A abstenon ndokush? Një abstenim.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 2, Neni 2, zëvendëso paragrafin 4, me këtë në vijim: “Legjislacioni doganor në Kosovës, do të thotë legjislacioni që ka për lëndë kryesore vendosjen e tarifave doganore, vlerësimin e detyrimeve doganore apo procedurat dhe rregullat që qeverisin çështjet e tjera standarde”, zëvendëso paragrafin 11 me këtë në vijim: “Shtet i jashtëm do të thotë:

1. Çdo shtet apo territor i huaj në shërbim të veçantë doganor, dhe
2. Çdo territor ose nëndarje politike të një shteti të tillë apo territori të huaj me shërbim të veçantë doganor.”. Dhe, të fshihet paragrafi 18.

Kush është për? Ju falemnderit.

Kush është kundër? 13 kundër.

A abstenon ndokush? Një abstenim.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 3, Neni 4, shtohet neni i ri pas nenit 4.1. E keni 4.1. – 4.5., të mos i lexojë.

Kush është për? Ju falemnderit.

Kush është kundër? 13 kundër.

A abstenon ndokush? Një abstenim.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 4, Neni 10, zëvendëso fjalën “kombëtare” me fjalën “vendore” në titull.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? 13 kundër.

A abstenon ndokush? Dy abstenime.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 5, Neni 13, - 13.3. të fshihet, e para “mbrojtja e interesave themelore të sigurisë së Kosovës”.

Kush është për? Ju falemnderit.

Kush është kundër? 13 kundër.

A abstenon ndokush? Dy abstenime.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 6, Neni 16, të fshihen nënparagrafet a) deri në c).

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? 13 kundër.

A abstenon ndokush? Dy abstenime.

Amendamenti miratohet.

Amendamenti 7, Neni 18, - Neni 18 të zëvendësohet “a) deri në h)” me “a) deri në e)”.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? 13 kundër.

A abstenon kush? Një abstenim.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 8, Të shtohet nen i ri, pas nenit 49, “Neni 20 në koordinim me UNMIK-un: veprimet dhe vendimet në nenet 9.1, 12.4, 23.1, 24.1, 26.1 dhe 38.1 do të bëhen në koordinim të ngushtë me UNMIK-unn”.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? 13 kundër.

A ka abstenime? Një abstenim.

Miratohet propozimi i amendamentit.

Amendamenti 9, Neni 50, shto këtë fjali në vazhdim të paragrafit: “Çdo konflikt në mes të këtij ligji dhe legjislacionit tjetër përfshirë edhe legjislacionin tjetër në të ardhmen që ka të bëjë me ndonjë çështje që rregullohet nga ky ligj, do të zgjidhet në favor të këtij ligji”.

Urdhëro, për sqarim.

SABRI HAMITI:

Po përpiqem pak arsyeshëm dhe kujdesshëm të dij çka po votojmë këtu dhe kur lexova këtë formulim nuk pata shumë të qartë qysh paragjykohet me të, me formulimin e tij. Ju lutem shumë, le të japë sqarime Komisioni që e ka propozuar. Paragrafi, thotë “çdo konflikt, në mes këtij ligji dhe legjislacionit tjetër, përfshirë edhe legjislacionin tjetër në të ardhmen” - jo në të shkuaren por edhe në të ardhmen; “që ka të bëjë me ndonjë çështje, të rregullohet nga ky ligj do të zgjidhet në favor të këtij ligji”. Ju lutem, e dua një arsytim plus. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

A ka kush ndonjë mendim të kundërt këtij që tha zoti Hamiti? Nuk ka.

Prandaj, edhe një herë po them, është krejtësisht e paqartë... A ka kush nga Komisioni që do ta arsyetojë? Nëse jo, do të thotë se nuk aprovohet.

Kush është në favor të këtij që ka bërë Komisioni? Asnjë votë për.

Nuk miratohet propozimi i amendamentit.

E kemi edhe një shtojcë. Zoti Gani Prekopuca ka një nen të veçantë... Urdhëroni.

GANI PREKOPUCA:

Zoti kryetar, deputetë të nderuar,

Nuk kemi amendament të veçantë, por është vetëm një lëshim tek amendamentet e propozuara, meqë ne të dyja palët ramë në dakord që në nenin 30 të fshihen prej pikës a) deri te pika d) dhe pastaj të bëhet korrekture vijuese ku bëhet referencë në ato pika.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Mendoj se plotësimi duket shumë i arsyeshëm.

Kush është për këtë propozim të zotit Prekopuca? Ju falemnderit.

Kush është kundër? 13 kundër.

A abstenon ndokush? Një abstenim.

Aprovohet ky propozim, dhe le të formulohet në mënyrën e duhur.

Vë në votim amendamentet në tërësi.

Kush është për? Ju falemnderit.

Kush është kundër? 13 kundër.

A abstenon ndokush? Një abstenim.

Miratohen amendamentet e diskutuara në këtë seancë të sotme.

Nën pikën 7 kemi: **Parashtrimi i pyetjeve.**

Është parashtruar një pyetje me kohë. Përgjegjja me shkrim është dhënë. Urdhëro Alush.

ALUSH GASHI:

I nderuar kryetar, të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë, të nderuar ministra,

Në bazë të Rregullës 23 të Rregullores së përkohshme të Kuvendit të Kosovës, i kam parashtruar pyetje zotit kryeministër: **cili është vizioni i Qeverisë për Trupat Mbrojtëse të Kosovës.**

Duke iu falënderuar kryeministrit për një përgjegje teknike se si janë të caktuara detyrat dhe kompetencat e TMK në Kornizë kushtetuese, nuk më është dhënë përgjegjja se cili është vizioni i Qeverisë së Kosovës për Trupat Mbrojtëse të Kosovës. Andaj, në bazë të Rregullorsë në fuqi, ftoj kryeministrin në interpelancë dhe përgjigje gojore. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit, zoti deputet. Urdhëro, por pyetjet mund të bëhen edhe me shkrim.

RAMADAN KELMENDI:

I nderuari kryetar, të nderuar të pranishëm, më parë propozova një pikë të futet në rend të ditës, por tani kam një propozim edhe më konkret: **që Qeveria e Kosovës, të përgatisë një informatë për të gjithë deputetët lidhur me mosrealizimin e marrëveshjes për integrimin e qytetit të Mitrovicës dhe mbi pasigurinë që dominon atje relativisht gjatë si dhe të prezentojë – pse në pjesën veriore të qytetit nuk janë në përbërje të Shërbimit Policor të Kosovës edhe pjesëtarët shqiptarë? Ju falemnderit.**

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Mund ta bëni me shkrim në mënyrë që të jetë konform me Rregulloren.

Kalojmë në pikën e fundit të rendit të ditës: **Propozimi i rendit të ditës për seancën plenare më 15 maj 2003.**

Rendin e propozuar të ditës e keni marrë.

Në qoftë se do të ketë ndonjë pikë plotësuese, mendoj se në mbledhjen e parë të Kryesisë do të mirret në shqyrtim.

Konsideroj, se propozimi aprovohet?

Me këtë përfundojmë punën e seancës së sotme.

Ju falemnderit për kontributin e dhënë në këtë seancë.

Mirëupafshim në seancë ne ardhshme plenare.

Seanca përfundoi në orën 13,50.

1-35/RT